



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9244 prot.

Himarë, më 30 . 12 . 2025

VENDIM

Nr. 63 , Datë 22/12 /2025

“PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOSSHME, PËR VITIN 2026”

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, si dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë; Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 22.12.2025, pasi shqyrtoi materialin e sjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike e miratoi me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 8 (tetë) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, për Bashkinë Himarë, i cili do të jetë 62 punonjës në total.
2. Nga këta 34 punonjës sezonal për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, 3 edukatorë kopshti zëvendësues ose ndihmës, 7 roje pyjesh sezonal, 6 roje zjarresh dhe 12 punonjës plazhi.
3. Paga do të bëhet bazuar në vendimin nr.28, datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë”.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

